

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	El Niño dhe ngrohja globale/ Rekord avujsh uji në atmosferë, rritet rreziku për nxehtësi dhe reshje ekstreme
ADRESA	https://albeu.com/lajme/bota/el-nino-dhe-ngrohja-globale-rekord-avujsh-uji-ne-atmosfere-rritet-rreziku-per-nxehtesi-dhe-reshje-ekstreme/1016738/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 05:23:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 05:19:27 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	eea610024380137b287a1506915b9ba1ff7737906bd34657cb3846f26c4678df
TEKSTI	914568f9e0fab6396726dc0aa4df27c2065d0b2d6205dc5ababed93daa6b7894
PAMJA	62a965ae61caef30e1f775355f3a807812cc88f2b54c58f0d4c7e4aaca033f4e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3befabb5907c7ae066099922697eac53e16db5ed74e5a0019f8d4e82bff23733
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0c0dec12bc237ce7a3b53840342154b6dec8e6e0aa6a337693272add88847ea6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3befabb5907c7ae066099922697eac53e16db5ed74e5a0019f8d4e82bff23733>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

El Niño dhe ngrohja globale/ Rekord avujsh uji në atmosferë, rritet rreziku për nxehtësi dhe reshje ekstreme



Në gusht, atmosfera e Tokës regjistroi nivelin më të lartë të avujve të ujit të matur ndonjëherë. Sipas shkencëtarëve, kjo situatë mund të favorizojë valë më të fuqishme të të nxehtësisë dhe reshje ekstreme në zona të ndryshme të globit.

Informacioni është publikuar nga Shërbimi i Ndryshimeve Klimatike i programit evropian Copernicus (C3S). Ekspertët e lidhin rekordin me ngrohjen globale, pasi ajri më i ngrohtë ka aftësi të mbajë më shumë lagështi. Në këtë rritje mendohet të ketë ndikuar edhe fenomeni El Niño në Oqeanin Paqësor.

Gjatë gushtit, sasia e avujve të ujit arriti në 27.35 kilogramë për metër katror, sipas matjeve të C3S.

Kjo shifër është 0.04 kilogramë për metër katror më e lartë se rekordi i mëparshëm, i shënuar në korrik të vitit 2024.

Matja përfaqëson sasinë e avujve të ujit që gjendet në një kolonë ajri mbi një metër katror të sipërfaqes së Tokës dhe që përfshin të gjithë shtrirjen e atmosferës.

Shkencëtarët kanë llogaritur se shtesa prej 0.04 kg/m² krahasuar me rekordin e kaluar përkthehet në rreth 20 trilionë litra ujë më shumë në atmosferë.

Julien Nicolas, shkencëtar i lartë në C3S, deklaroi se rekordi i ri për avujt e ujit përputhet me temperaturat jashtëzakonisht të larta globale të regjistruara në gusht.

Ai shpjegoi se për çdo një gradë Celsius ngrohje globale, ajri mund të mbajë rreth 7% më shumë avuj uji.

Oqeanet tropikale janë në prei burimeve krvesore të lagështisë atmosferike. Në gusht, temperaturat shumë të

të fundit /



Institucionet e drejtësisë e kundërshtuan,...



Kushte atmosferike të qëndrueshme/ Parashikimi i motit, 1...



Sot zhvillohet ceremonia mortore për Flora Brovinën



Protestë gjithëpopullore sot në mesditë në sheshin "Skënderbeu



Horoskopi 18 Shtator, zbuloni surprizat për secilën shenjë



Reagim i Elton Guranjakut pas deklaratave të Emilja...



Floyd Samba shkëlqen në debutim, realizon dy herë në triumfin 5-0 t...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Iarta të sipërfaqes së detit në këto rajone, të lidhura pjesërisht me forcimin e kushteve të El Niño-s, shtuan avullimin dhe besohet se kontribuuan në arritjen e rekordit.

Një përqendrim më i madh i avujve të ujit mund të rrisë intensitetin e reshjeve, përfshirë ato që shoqërojnë ciklonet dhe stuhitë e fuqishme.

Gjatë kondensimit, kur avujt e ujit kthehen në pika brenda reve, çlirohet nxehtësi. Kjo energji mund të ndihmojë në forcimin e stuhive.

Lagështia e lartë mund t'i bëjë gjithashtu më të rrezikshme valët e të nxehtë. Ajo pengon uljen e temperaturave gjatë natës dhe e vështirëson rikuperimin e organizmit pas ditëve me nxehtësi ekstreme.

Të dhënat ERA5 të Copernicus, të cilat përfshijnë periudhën deri në vitin 1940, tregojnë se gushti ishte ndër muajt më të nxehtë të regjistruar ndonjëherë.

Ndërsa seria e matjeve të administratës amerikane NOAA, e cila nis në vitin 1850, e klasifikoi gushtin si muajin më të nxehtë të regjistruar në historinë e saj.

Shkencëtarët ia atribuojnë këtë prirje emetimeve të gazeve serrë që krijohen nga djegia e lëndëve djegëse fosile. Një ndikim në rritjen e temperaturave globale ka pasur edhe El Niño.

Avujt e ujit janë një gaz serrë dhe kanë rol të rëndësishëm në funksionimin e sistemit klimatik të Tokës.

Me rritjen e temperaturës së atmosferës, shtohet edhe kapaciteti i saj për të mbajtur avujt ujë. Lagështia e akumuluar mund të forcojë më tej efektin serrë dhe të përshpejtojë ngrohjen.

Edhe pse ndryshimi i regjistruar mund të duket i vogël në vlerë absolute, shkencëtarët nënvizojnë se rritja e vazhdueshme e lagështisë në atmosferë mund të ndikojë ndjeshëm te temperaturat ekstreme, reshjet dhe stuhitë.

El Niño që po zhvillohet në Paqësorin tropikal pritet të jetë ndër episodet më të fuqishme të regjistruara. Sipas paralajmërimeve të shkencëtarëve, ky fenomen mund të ndikojë në temperaturat globale edhe gjatë vitit të ardhshëm.

Shtuar më 18.09.2026 07:19



Greçia synon uljen e çmimit të naftës për ngrohje dhe shtimin e ndihmës,...



Përplasje fatale në Greqi, tre të rinj shqiptarë humbin jetën dhe dy të tjerë...



Kristersson largohet nga posti pas zgjedhjeve në Suedi, e majta merr...



Trump paralajmëron BE-në për tarifa të rënda pas afrimit me Kanadanë



Gjendet në pellg trupi i 3-vjeçarit, babai: Noah ishte i ëmbël, i pafajshëm dhe p...



Erdogan: Anëtarësimi në BE nuk është më përparësi për Turqinë, humbjen do ...



Indonezi, çifti merr nga 100 goditje me kamxhik për tradhti bashkëshortore;...



Carney përhëndet synimin e BE-së për forcimin e aleancës strategjike me...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Kategori

Linqet

Tags

Moti

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.